



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 9284/Pfot

Gramsh, më 17.11.2021

**VENDIM**

Nr. 115 datë 17.11.2021

**“PËR  
MIRATIMIN E THEMELIMIT TË SHOQËRISË TREGTARE TË PËRBASHKËT  
“ECO ELB” SH.A**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, pika (d) të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të nenit 3, pika 1 dhe nenit 105 e vijues të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të neneve 26, 28, 32 e 36 të Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Gramsh, si organi përfaqësues i personit juridik publik, Bashkia Gramsh, duke marrë në konsideratë faktin se Kontrata Koncesionare e formës “BOT”, e lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “ALBTEK ENERGY” shpk, me objekt “Ndërtimin, Administrimin dhe Transferimin e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan”, përfundon në datën 16.12.2021, si dhe duke vlerësuar nevojën që nëpërmjet aktivitetit tregtar të ushtruar nga një shoqëri tregtare e përbashkët ndërvendore, të përmbushë në vazhdim funksionin vendor për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, në kushtet kur nuk vlerësohet efçente asnjë mënyrë tjetër për ushtrimin e këtij funksioni, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_11.2021, pasi mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Gramsh,

**VENDOSI**

1. Të miratojë themelimin e shoqërisë tregtare të përbashkët me emërtimin “ECO Elb” Sh.a, në formën e një shoqërie aksionare me ofertë private.
2. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë aksionare “ECO Elb” sh.a, dokumente të cilat i bashkëngjiten këtij vendimit dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I BASHKISË GRAMSH

KRYETAR

Greta-LENA

Konc.Dakt:Xh.Gjini

Pranoi: G.Lena

Miratoi:G.Lena

Dosja \_\_\_\_\_

